



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER REZARTA B. KOÇI  
ADRESA NR.9, BLV"ZOGU I PARE",  
NR.97, NR.1, NR.1  
TEL: 672041909

# KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 2428

Nr. koleksioni: 697

Tirane më 08/05/2020

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

\*Akti noterial përbëhet nga 3 fletë



A2020053080049529004



A2020053080049529004



## KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME KUOTA KAPITALI

Sot, më datë 08.05.2020, para meje Notere REZARTA B. KOÇI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën TIRANE, NR.9, BLV"ZOGU I PARE", NR.97, NR.1, NR.1, u paraqit personalisht:

### SHITES:

**Julian Hyka**, atësia Alush, amësia Bajame, shtetas Shqiptar, lindur në Kuçovë, Berardhe banues në TIRANE, me adresë 1052 Yzberish Rr.'Migjeni' Ap.27 shk.2, lindur më 24/09/1976, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034177639 dhe nr. personal H60924002P, .  
*(këtu e më poshtë për efektet e kësaj kontrate, cilësuar si **Shitës**).*

### BLERES:

**Shoqëria CHICKEN FARM ALBANIA**, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS L33431801N, me seli në adresë Agonas, përfaqësuar nga Administratori Marenglen Meqemeja, atësia Ahmet, amësia Nadja, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANE, me adresë 1023 Njesia bashkiake nr. 7 Naim Frasheri 84 2 45, lindur më 10/07/1978, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 031134486 dhe nr. personal H807100750.  
*(këtu e më poshtë për efektet e kësaj kontrate, cilësuar si **Blerës**).*

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noterja konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noterja hartimin e Kontratës së Shitjes, sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore, si më poshtë vijon:

### KUSHTE PARAPRAKE:

**Shoqëria "URBAN DISTRIBUTION" shpk** është person juridik shqiptar, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit më datë 18.01.2008 dhe e pajisur me NIPT- K81318001M;

**Z. Julian Hyka**, është Ortak i Vetëm i shoqërisë "URBAN DISTRIBUTION" shpk, zotëron 100 (njëqind) kuota në kapitalin themeltar të shoqërisë, të cilat përfaqësojnë 100 % (njëqind përqind) të kapitalit themeltar në shoqërinë "URBAN DISTRIBUTION" shpk, e regjistruar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe shpreh vullnetin e tij për të shitur këto kuota tek **Blerësi**;

**Shoqëria "CHICKEN FARM ALBANIA" shpk**, e përfaqësuar nga **Z. Marenglen Meqemeja**, shpreh dëshirën dhe miratimin e saj për të blerë kuotat e ofruara nga Ortaku Vetëm i shoqërisë "URBAN DISTRIBUTION" shpk, **Z. Julian Hyka**.

Bazuar në sa më sipër, **Palët** kanë ranë dakord që të hartojnë këtë Kontratë me kushtet e mëposhtme:

### NENI 1



## OBJEKTI I KONTRATËS

- 1.1 *Shitësi* do të transferojë tek *Blerësi* nëpërmjet shitjes, 100 (njëqind) kuota, që përfaqësojnë 100 % (njëqind përqind) të kapitalit të shoqërisë “URBAN DISTRIBUTION” sh.p.k, sipas Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme, datë 07.05.2020, bashkangjitur kësaj Kontrate.
- 1.2 *Blerësi* pranon të blejë 100 (njëqind) kuotat që *Shitësi* zotëron tek shoqëria “URBAN DISTRIBUTION” sh.p.k., sipas vullnetit të shprehur të tij me Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, datë 07.05.2020, bashkangjitur kësaj Kontrate.
- 1.3 Pas këtij transferimi, pjesëmarrja në kapitalin e shoqërisë “URBAN DISTRIBUTION” sh.p.k do të jetë si më poshtë:

**Shoqëria “CHICKEN FARM ALBANIA” sh.p.k.**, person juridik shqiptar, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit më datë 31.10.2013, me NIPT- L33431801N, përfaqësuar nga Administratori i saj Z. Marenglen Meqemeja, shtetas shqiptar, lindur më 10.07.1978, në Tiranë, banues në Tiranë, mbajtës i Kartës së Identitetit me Nr. Personal: H807100750, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, do të zotërojë 100 (njëqind) kuota, të cilat përfaqësojnë 100 % (njëqind përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.

## NENI 2 ÇMIMI I KONTRATËS

- 2.1 Pjesët e sipërpërmendura do të transferohen me vlerën e tyre nominale, që përbëhet nga 1000 (një mijë) Lekë për secilën kuotë.
- 2.2 *Shitësi* i transferon *Blerësit* 100 (njëqind) kuota, të cilat përfaqësojnë 100% (njëqind përqind) të pjesëve të kapitalit, me vlerën e tyre nominale, në shumën totale 100.000 (njëqind mijë) lekë.
- 2.3 Çmimi i kontratës do të paguhet nga *Blerësi* tek *Shitësi* nëpërmjet llogarisë bankare.

## NENI 3 TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE

- 3.1 *Shitësi* garanton *Blerësin* se pjesët e kapitalit janë të transferueshme dhe të lira nga çdo barrë dhe hipotekë, në përputhje me Vërtetimin përkatës të lëshuar nga Regjistri i Barrëve Siguruese.
- 3.2 Shoqëria “Chicken Farm Albania” shpk, pranon se në momentin e blerjes 100% (njëqind përqind) të kuotave është njohur me gjendjen financiare të shoqërisë “Urban Distribution” shpk sipas pasqyrave financiare të vitit 2019 dhe ka pranuar blerjen e kuotave të saj me të gjitha detyrimet financiare të papagura që kjo shoqëri ka ndaj palëve të treta dhe ndaj ish-Ortakut Themelues dhe Administratorit.
- 3.3 Shoqëria “Chicken Farm Albania” shpk pranon dhe merr përsipër të kontribuojë financiarisht tek shoqëria “Urban Distribution” shpk, brenda 60 ditëve nga momenti i nënshkrimit të kësaj kontrate, me këste, me qëllim që kjo e fundit të shlyejë detyrimet financiare ndaj palëve të treta dhe ndaj ish-Ortakut Themelues dhe Administratorit.
- 3.4 Radha e shlyerjes së detyrimeve financiare nga sipas pikës 3.3 do të jetë si vijon:
  - a. Detyrimet ndaj ish-Ortakut Themelues për kontributin e dhënë për financimin e kësaj shoqërie që në themelimin e saj.
  - b. Detyrimet për paga të palikuiduara ndaj administratorit të shoqërisë.
  - c. Detyrimet ndaj furnitorëve.
  - d. Detyrimet tatimore.
  - e. Hua te ndryshme,



f. Etj....

#### NENI 4 MOSMARRËVESHJET

- 4.1 Çdo konflikt apo mosmarrëveshje në lidhje me keqinterpretimin apo zbatimin e kësaj Kontrate do të zgjidhet me mirëkuptim nga *Palët*, në të kundërt, kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

#### NENI 5 TË NDRYSHME

- 5.1 Kjo Kontratë është hartuar në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe, me vlerë të njëjtë ligjore.  
5.2 Kontrata është hartuar në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe do të interpretohet sipas këtij legjislacioni.  
5.3 Kjo Kontratë hyn në fuqi nga data e nënshkrimit të saj nga të dyja palët.

Kontrata redaktohet në katër kopje origjinale, me përmbajtje dhe vlerë të njëjtë juridike, bashkëlidhur kësaj kontrate janë regjistri i barrave sigurorese dhe kopje e ekstrakteve të QKB-së të Shoqërisë nga të cilat një kopje ruhet në arshivën e Noteres.

Unë, Noterja, vërtetoj redaktimin korrekt të aktit dhe autenticitetin nënshkrimeve, në bazë të ligjit Nr. 110/2018, datë 20.12.2018 "Për Noterinë" si dhe në zbatim të ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" (*i ndryshuar*), unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

#### PALËT

##### SHITËSI

Z. Julian Hyka

Julian Hyka

##### BLERËSI

Shoqëria "CHICKEN FARM ALBANIA" shpk

Përfaqësuar nga:

Z. Marenglen Meqemeja

Marenglen Meqemeja

#### NOTERE



## VENDIM

### I

#### ORTAKUT TË VETËM TË SHOQËRISË "URBAN DISTRIBUTION" SHPK

Sot, më datë 07.05.2020 (dy mijë e njëzet), në selinë e shoqërisë "URBAN DISTRIBUTION" shpk, me adresë në "Sheshin Skënderbej", pranë Muzeut Kombëtar, Tiranë, person juridik shqiptar, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit më datë 18.01.2008, me NIPT-K81318001M, në cilësinë e Ortakut të Vetëm të kësaj shoqërie, unë, Julian Hyka, zotërues i 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë, shtetas shqiptar, lindur më 24.09.1976, në Kuçovë, banues në Tiranë, mbajtës i Kartës së Identitetit me Nr. Personal: H60924002P, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, pasi shqyrtova çështjet e rendit të ditës si më poshtë:

- 1- Shqyrtimi dhe miratimi i transferimit nëpërmjet shitjes së kuotave që **Z. Julian Hyka** zotëron në shoqërinë "URBAN DISTRIBUTION" shpk;
- 2- Të ndryshme.

#### VENDOSA:

- 1- Të transferojë nëpërmjet shitjes 100 (njëqind) kuota, që **Z. Julian Hyka**, shtetas shqiptar, lindur më 24.09.1976, në Kuçovë, banues në Tiranë, mbajtës i kartës së identitetit me Nr. Personal: H60924002P, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, zotëron tek shoqëria "URBAN DISTRIBUTION" shpk, person juridik shqiptar, regjistruar pranë QKB më datë 18.01.2008, me NIPT-K81318001M, të cilat përfaqësojnë 100 % (njëqind përqind) të kapitalit të saj themeltar;
- 2- Pas këtij transferimi, pjesëmarrja në kapitalin themeltar të shoqërisë "URBAN DISTRIBUTION" shpk do të jetë si më poshtë vijon:
  - Shoqëria "CHICKEN FARM ALBANIA" shpk, person juridik shqiptar, regjistruar pranë QKB-s më datë 31.10.2013, me NIPT- L33431801N do të zotërojë 100 (njëqind) kuota, të cilat përfaqësojnë 100 % (njëqind përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë;
- 3- Largimin nga shoqëria "URBAN DISTRIBUTION" shpk e ortakut **Z. Julian Hyka**;
- 4- Miratimin dhe nënshkrimin e *Kontratës së Shitjes së Kuotave* ndërmjet Shitësit dhe Blerësit shoqëria "CHICKEN FARM ALBANIA" shpk;



- 5- Të reflektoj këto ndryshime në Statutin e Ri të shoqërisë "URBAN DISTRIBUTION" sh.p.k.;
  
- 6- Të depozitojë Vendimin e Asamblesë së Ortakut të Vetëm, Kontratën e Shitjes së Kuotave dhe cdo dokumentacion tjetër të nevojshëm në lidhje me këtë procedurë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

**ORTAKU I VETËM  
I  
SHOQËRISË "URBAN DISTRIBUTION" SH.P.K**

**JULIAN HYKA**

*Julian Hyka*  
*[Signature]*



# **"CHICKEN FARM ALBANIA" Sh.p.k**

## **VENDIM**

### **I**

#### **ORTAKUT TË VETËM TË SHOQËRISË**

#### **"CHICKEN FARM ALBANIA" SHPK**

Sot, më datë 07.05.2020 (dy mijë e njëzet), në selinë e shoqërisë "Chicken Farm Albania" shpk, në Agonas, Kavajë, person juridik shqiptar, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit më datë 31.10.2013, me NIPT- L33431801N, në cilësinë e Ortakut të Vetëm të kësaj shoqërie, unë, Marenglen Meqemeja, zotërues i 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë, shtetas shqiptar, lindur më 10.07.1978, në Tiranë, banues në Tiranë, mbajtës i Kartës së Identitetit me Nr. Personal: H807100750, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, pasi shqyrtova çështjet e rendit të ditës si më poshtë:

- 1- Shqyrtimi dhe miratimi i blerjes së kuotave nga **Z. Julian Hyka** që zotëron në shoqërinë "Urban Distribution" shpk;
- 2- Të ndryshme.

#### **VENDOSA:**

- 1- Të blejë 100 (njëqind) kuota, që **Z. Julian Hyka**, shtetas shqiptar, lindur më 24.09.1976, në Kuçovë, banues në Tiranë, mbajtës i kartës së identitetit me Nr. Personal: H60924002P, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, zotëron tek shoqëria "URBAN DISTRIBUTION" shpk, person juridik shqiptar, regjistruar pranë QKB më datë 18.01.2008, me NIPT-K81318001M, e cila përfaqëson 100 % (njëqind përqind) të kapitalit të saj themeltar;
- 2- Pas blerjes së kuotës, në shoqërinë "URBAN DISTRIBUTION" shpk, shoqëria "CHICKEN FARM ALBANIA" shpk do të zotërojë 100 (njëqind) kuota, të cilat përfaqësojnë 100 % (njëqind përqind) të kapitalit të saj themeltar;
- 3- Miratimin dhe nënshkrimin e Kontratës së Shitjes së Kuotave me shitësin **Z. Julian Hyka**, Ortak i Vetëm i shoqërisë "URBAN DISTRIBUTION" shpk;
- 4- Të autorizojë administratorin e shoqërisë Z. Marenglen Meqemeja, shtetas shqiptar, lindur më 10.07.1978, në Tiranë, banues në Tiranë, mbajtës i Kartës së Identitetit me Nr. Personal: H807100750, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, që të nënshkruajë Kontratën e Shitjes së Kuotave dhe çdo dokument tjetër të nevojshëm në lidhje me këtë procedurë;



# **"CHICKEN FARM ALBANIA" Sh.p.k**

---

- 5- Të depozitojë Vendimin e Asamblesë së Ortakut të Vetëm, Kontratën e Shitjes së Kuotave dhe cdo dokumentacion tjetër të nevojshëm në lidhje me këtë procedurë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

**ORTAKU I VETËM  
I  
SHOQËRISË "CHICKEN FARM ALBANIA" SH.P.K**

**MARENGLËN MEQEMEJA**

*Marenglen Meqemeja*





**REZULTATET E KËRKIMIT**

Numri i Rezultatit të Kërkimit: D-2020050813174184  
Data e Rezultatit të Kërkimit: 08.05.2020  
Ora e Rezultatit të Kërkimit: 1:17:04PM  
Lloji i Kërkimit:  
Numri i Dokumentit: D-400-626-1743  
Referenca e Përdoruesit:

**LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KËRKIMI 0**

URBAN DISTRIBUTION SH.P.K.



*Alisa Zekaj*